



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

INSPEKTORATI QENDROR

MESAZH I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

Inspektorati Qendror, si një institucion udhëheqës, koordinues dhe rregullator për të gjitha Inspektoratet Shtetërore, si dhe për të garantuar se veprimtaria inspektuese do të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat strategjike të tij, për mbrotjen e interesave publike, edhe përgjatë vitit 2017 ka patur në fokus kryerjen e inspektimeve on-line.

Efiçienca e kërkuar në procesin e inspektimeve ka çuar në zhvillime dhe ndryshime të shumta thelbësore në veprimtarinë inspektuese. Këto ndryshime janë të gjithanshme, konceptuale, praktike, ligjore dhe institucionale.

Kjo ka kërkuar më shumë përkushtim e profesionalizëm, dhe përdorim sa më efektiv të burimeve njerëzore nëpërmjet rritjes së tyre profesionale, si dhe promovimin e një procesi të dixhitalizuar inspektues, i cili duhet të jetë detyrë dhe angazhim jo vetëm i IQ, por i të gjithë trupave inspektuese.

Inspektorati Qendror, siguron se këta tregues si: integriteti, kompetenca e inspektorit, si dhe transparenca në procesin e inspektimit, kanë potencialin të rrisin besimin e qytetarëve tek veprimtaria inspektuese dhe për këtë duhet të angazhohen të gjithë aktorët dhe faktorët e përfshirë në këtë proces.

Inspektimi on-line synohet të jetë një vlerë e shtuar në veprimtarinë e inspektorateve shtetërore, si një qasje e re e perceptimit të inspektimeve të dixhitalizuara, duke e konsideruar tashmë këtë si një proces të rregullt administrativ ligjor, kundrejt një procesi tradicional me blloqe.

Viti 2017, me gjithë vështirësitë e hasura në planin e brendshëm kishte prioritet rritjen e numrit të përdoruesve të sistemit “e-Inspektimi”, nga të gjitha inspektoratet shtetërore, duke mundësuar në këtë mënyrë aktivizimin e potencialeve për inovacion, duke i shndërruar ato nga një praktikë manuale, në një strukturë të dixhitalizuar.

Inspektorati Qendror, gjatë gjithë këtij viti ka bashkëpunuar me Inspektoratet Shtetërore, bizneset e dhomat e biznesit, vendase e të huaja, duke theksuar se inspektimet on-line, janë zgjidhje shëruese për korrupsionin e klientelizmin në fushën e inspektimeve.

Inspektorati Qendror, gjatë vitit 2018, do të integrojë sistemin e inspektimeve nëpërmjet tabletave (audio dhe video), duke e cilësuar një histori sukseesi, sepse nëpërmjet sistemit të tabletave kemi një pasqyrim në kohë reale të procesit të inspektimit nga trupat inspektuese, nënshkrimin elektronik, duke e shoqëruar procesin e inspektimit me dokumente të filmuara, para përpilimit të aktit administrativ final.

Ju informojmë se përgjatë vitit 2018, edhe inspektoratet vendore do të formalizohen nga ana metodologjike me përshtatjen e dokumenteve standarde dhe hartimin e listë-verifikimeve, të cilat do të implementohen në sistem, si dhe do të pajisen me paketa portabël me qëllim që vitin e ardhshëm edhe ato të kryejnë inspektime on-line.

Roli i inspektorëve shtetërorë do të fokusohet më shumë në këshillime e udhëzime për biznesin, se sa në sanksione e devijime nga zbatimi i ligjit, duke u fokusuar në ndërgjegjësimin e publikut dhe parandalimin e risqeve ndaj konsumatorit.

Duke vlerësuar ecurinë e ristrukturimit në fushën e inspektimeve në përgjithësi, i cili është mbështetur në eksperiencën dhe asistencën e vendeve më të zhvilluara të BE-së, ky vit u karakterizua nga një gjallërim i mëtejshëm, për transformimin e inspektorateve në trupa profesionistësh dhe me sistem karriere.

Në emër të Inspektoratit Qendror, dëshiroj të garantoj se veprimtaria e këtij institucioni do të jetë e vendosur që inspektimet on-line të realizohen në të gjithë vendin, duke minimizuar fenomenet e gjobëvënies apo sjelljeve abuzive të trupave të inspektimit, duke shmangur korrupsionin, rritur transparencën, duke mbështetur biznesin e ndershëm dhe duke luftuar informalitetin, si rruga e vetme drejt standardeve që kërkon Bashkimi Evropian.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI

PËRMBAJTJA

MESAZHI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

I. PËRMBLEDHJE

II. HYRJE

Qëllimi
Objektivat
Metodologjia

III. DIXHITALIZIMI I INSPEKTIMEVE

VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT.

- 1) Ministria e Brendshme;
- 2) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- 3) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 4) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 5) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- 6) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- 7) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

V. KOMENTE

VI. PRAKTIKAT E MIRA

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

VIII. REKOMANDIME

IX. KONKLUZIONE

I. PËRMBLEDHJE

Inspektimet janë një prej veprimtarive më të rëndësishme për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore në një shoqëri. Ato qëndrojnë në pararojë, për të siguruar që qytetarët dhe bizneset të kenë shërbime cilësore dhe sa më të sigurta.

Në të njëjtën kohë, ne e dimë që inspektimet janë një prej sektorëve më të ekspozuar ndaj korrupsionit. Kështu që, rritja e transparencës së inspektimeve, profesionalizimit dhe integritetit të inspektorëve, është një prej reformave për luftimin e korrupsionit dhe përbën një sferë të rëndësishme për integrimin e Shqipërisë dhe antarësimin në Bashkimin Evropian.

Sistemi i Inspektimeve në Republikën e Shqipërisë ka nevojë thelbësore të përmirësohet, me qëllim që të krijojme trupa inspektimi të pavarura, bazuar në kriteret profesionale e karriere, me pritshmëri rritjen e efektivitetit, transparencës, gjurmueshmërisë, koordinimit të inspektimit, reduktim të abuzivitetit dhe kosto sa më të ulët administrative ndaj biznesit formal. Kjo është rruga e vetme për të ulur barrën ndaj biznesit të ndershëm, formalizimit të ekonomisë, duke e përshtatur me standardet që kërkon tregu i brendshëm dhe ai ndërkombëtar.

IQ, si një institucion që drejton gjithë procesin e dixhitalizimit dhe standardizimit të veprimtarisë inspektuese, në nivel qendror dhe vendor, ka sjellë një qasje të re për rikonceptimin e inspektimit, duke e afruar atë me standarde bashkëkohore që detyron inspektoratet shtetërore të kryejnë inspektime on-line pranë subjekteve në kohë reale, si një proces i rregullt administrativ e ligjor.

Kryerja e inspektimeve on-line, si një sfidë e “qeverisjes elektronike”, ka vendosur standarde të reja në kryerjen e veprimtarisë inspektuese, me dokumente të standardizuara dhe listë-verifikimi, pranë dhe në prani të biznesit dhe enteve publike, me qëllim shmangien e korrupsionit, klientelizmit, duke i dhënë më shumë autonomi trupave inspektuese në terren.

Përgjatë vitit 2017, Inspektorati Qendror ka përcaktuar si objektiv kryesor kryerjen e inspektimeve on-line pranë subjekteve nga çdo inspektorat shtetëror (ISH).

Për arritjen e këtij objektiv, janë ndjekur politika të orientuara, me qëllim rritjen e numrit të përdoruesve të Inspektorateve Shtetërore për vënien në eficiencë të sistemit “e-Inspektimi”, si dhe në drejtim të ngritjes së performancës së kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Inspektorati Qendror, në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese ka përfunduar tashmë dokumentacionin standard dhe listë-verifikimet, për të gjitha fushat e inspektimit, të cilat janë edhe të implementuara në sistemin “e-Inspektimi”.

Gjithashtu, është realizuar komunikimi i sistemit unik “e-Inspektimi”, me platformën qeveritare të ndërveprimit.

Referuar të dhënave në sistemin “e-Inspektimi”, për vitin 2017, janë kryer inspektime on-line gjithsej 13.444, krahasuar me 5.060 inspektime on-line për vitin 2016, pra vihet re një rritje prej 2.6 herë më shumë, por përsëri nuk është në pritshëmëritë e IQ.

Raporti i Përgjithshëm për inspektimet në Republikën e Shqipërisë për vitin 2017, përfshin veprimtarinë e Inspektoratit Qendror, konkluzionet, gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e performancës së Inspektorateve Shtetërore dhe për përhapjen e praktikave më të mira.

Ky raport paraqet ecurinë e procesit inspektues lidhur me planifikimin dhe programimin e veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së riskut, standardizimin e procedurës së inspektimit, inspektimet on-line, trajnimet për rritje të performancës së inspektorëve shtetërorë.

Inspektorati Qendror, ka ndjekur dhe ka asistuar rregullisht pranë të gjitha inspektorateve shtetërore duke mbikëqyrur ecurinë e procesit on-line të inspektimeve, për të evidentuar problematikat gjatë këtij procesi me qëllim eliminimin e tyre, që ky proces të vijojë normalisht, duke bërë që numri i inspektimeve të kryera on-line pranë subjekteve të ndryshme, të jetë gjithnjë në rritje.

Gjithashtu, Inspektorati Qendror, ka dhënë edhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese lidhur me, pajtueshmërinë e zbatimit të ligjeve sektoriale në raport me ligjin e inspektimit, pajtueshmërinë në respektimin e kërkesave ligjore nga ana e subjekteve inspektuese, përshtatjen dhe pajtueshmërinë e dokumentacionin standard dhe implementimin e tij në sistemin “e-Inspektimi”, për të gjitha inspektoratet, për arritjen e objektivave dhe synimet strategjike të Inspektoratit Qendror.

Inspektorati Qendror, ka përditësuar Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë dhe Vendorë në detyrë, i cili është i publikuar në faqen zyrtare www.insq.gov.al, si dhe ka pajisur të gjithë inspektorët shtetërorë me kartën e inspektorit me numrin unik të identifikimit.

Janë organizuar takime për informimin dhe ndërgjegjësimin e biznesit, publikut dhe trupave inspektuese, me qëllim sensibilizimin e tyre për kryerjen e procedurave inspektuese on-line.

Ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me vendet e rajonit, si dhe ka nënshkruar marrëveshjen me Inspektoratin e Përgjithshëm të Administratës Franceze, (IGA) për fillimin e bashkëpunimit për reformimin strukturor të inspektorateve shtetërore, për përmirësimin e kuadrit ligjor drejt përafrimit të praktikave të BE, si dhe për trajnimin e trupave inspektuese.

Për formalizimin e ekonomisë dhe rritjen e transparencës së punës së Inspektorateve Shtetërore në zbatim të ligjit, qeveria ka ngritur komitetin drejtues për ndjekjen e procesit të ristrukturimit të instiucioneve të varësisë, ku bëjnë pjesë IQ dhe ISH, me qëllim riorganizimin e tyre, si një trupë profesionistësh dhe me sistem karriere.

Një ndër objektivat e rëndësishmëm për këtë vit, është integrimi i inspektorateve vendore në sistemin unik të inspektimeve “e-Inspektimi” dhe për këtë IQ, do t’i mbështesë nga ana metodologjike për përshtatjen e dokumenteve standarde dhe hartimin e listë-verifikimeve, si dhe do t’i pajisë me paketa portabël me qëllim kryerjen inspektimeve on-line.

Gjithashtu, prioritet i jonë pas reformimit dhe ristrukturimit të ISH-ve, është edhe ndërtimi i një objekti multifunksional ku do të akomodohen Inspektorati Qendror, Inspektoratet Shtetërore, laboratorë të pavarur të akredituar, për kryerjen e analizave shkencore të kampioneve që merren gjatë kryerjes së inspektimeve për fusha të caktuara.

II. HYRJE

Raporti është mbështetur në objektivat strategjik 2014-2017 dhe planin vjetor 2017, si një përmbledhje e rezultateve të arritura në procesin inspektues dhe impaktit që jep në mbrojtjen e interesit publik të personave fizik dhe juridikë.

Inspektorati Qendror, përgjatë këtij viti duke patur në fokus të veprimtarisë së tij kryerjen e inspektimve on-line, ka orientuar politikat zhvillimore drejt përmirësimit dhe zgjerimit të përdoruesve të sistemit “e-Inspektimi”, për vënien në eficiencë të tij, në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve duke e bërë këtë strukturë dixhitale më të konsoliduar dhe më lehtësisht të aksesueshme.

Inspektorati Qendror, ka bashkëpunuar me inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese dhe tashmë ka përfunduar unifikimin e të gjithë dokumentacionit standard dhe listë-verifikimet, për të gjitha fushat e inspektimit, si dhe implementimin e tyre në sistem.

Nëpërmjet kryerjes së inspektimeve on-line, synohet të rritet transparenca e punës së inspektorëve shtetërore, minimizimi i korrupsionit dhe abuzivizmit, siguria dhe besimi në procesin e inspektimit, jo vetëm për bizneset e sipërmarrjet private vendase, por edhe ato ndërkombëtare.

Qëllimi i Raportit

Përmes këtij Raporti, IQ bën të njohur veprimtarinë e tij, rezultatet e arritura në fushën e inspektimeve, zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor nga ana e inspektorateve shtetërore, problematikat me të cilat është hasur gjatë vitit raportues për përdorimin e sistemit, standardizimin e dokumentacionit të procesit inspektues, duke dhënë edhe rekomandime në funksion të përmirësimit të efektivitetit të veprimtarisë inspektuese.

Stafi përgjegjës i IQ, për vitin 2017, reflektoi angazhimin dhe përkushtimin një vjeçar të tij në drejtim të realizimit të objektivave për të mundësuar një proces inspektues sa më efektiv me qëllim përdorimin e sistemit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”, nga të gjitha inspektoratet shtetërore.

Objektivat e Raportit

Hartimi i këtij raporti bëhet në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe të planit të veprimit për 2017, lidhur me:

1. Dixhitalizimin dhe standardizimin e veprimtarisë inspektuese, për të kryer inspektime on-line, nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”.
2. Programimin e inspektimeve bazuar mbi vlerësimin e riskut, dokumentimin e veprimtarisë inspektuese konform ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale.
3. Bashkërendimin e veprimtarinë inspektuese për të rritur efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e veprimtarisë inspektuese.
4. Paraqitja e raportit për njohje Këshillit të Ministrave, sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.
5. Vendosjen e rregullave dhe unifikimi i treguesve të efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë inspektuese dhe procedurës së raportimit nga Inspektoratet Shtetërore sipas detyrimeve të ligjit për inspektimin.
6. Fushata ndërgjegjësuere me biznesin me synim njohjen e kuadrit ligjor për inspektimin.
7. Dhënien e kontributit në sensibilizimin e biznesit dhe publikut për dobitë e kryerjes së veprimtarisë inspektuese on-line.
8. Ngritjen e kapaciteteve të trupës inspektuese nëpërmjet trajnimeve.
9. Vlerësimin e inspektorëve shtetërore në bashkëpunim me DAP.

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur është ajo e raportimit në mënyrë progresive të inspektimeve on-line në sistemin e inspektimit, si dhe vlerësimi i arritjes së objektivave planit të veprimit për vitin 2017 të Inspektoratit Qendror.

Gjithashtu, për hartimin e Raportit të Përgjithshëm vjetor të inspektimit u analizuan raportet vjetore të hartuara nga Inspektoratet Shtetërore për vitin 2017, për fushat e inspektimit që ato mbulojnë.

Pas analizës së përgjithshme të sistemit, jepen edhe konkluzionet dhe rekomanimet për përmirësimin e punës, rritjen e efektivitetit dhe fuqizimin e Inspektorateve Shtetërore.

III. DIXHITALIZIMI I INSPEKTIMEVE

Inspektorati Qendror, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të realizuar objektivat, ka zhvilluar aktivitete të shumta me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarisë inspektuese.

Gjatë vitit 2017, Inspektorati Qendror ka zhvilluar takime periodike pune të përbashkëta me Kryeinspektorët me synim kryerjen e inspektimeve on-line nga të gjitha ISH. Janë finalizuar dokumentet standarde dhe është bërë përditësimi i listë-verifikimeve, implementimi i tyre në sistem. Në këtë kuadër janë zhvilluar takime me grupet e punës për hartimin e listë-verifikimeve, identifikimin e problematikave gjatë përdorimit të sistemit dhe zgjidhjen e tyre.

Gjithashtu, janë ritrajnua grupe inspektorësh dhe të gjithë specialistët e IT, train of trainers për përdorimin e sistemit, për të asistuar teknikisht gjatë inspektimeve on-line për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore.

Për ndërtimin e politikave më të mira dhe për të programuar inspektime bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut sipas standardeve të BE, janë përzgjedhur inspektorate pilot: Inspektorati Shtetëror Shendetsor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

✓ *Përdorimi i Sistemit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”*

Inspektorati Qendror, për të realizuar objektivin e tij kryesor lidhur me kryerjen e inspektimeve on-line, nga të gjitha trupat inspektuese gjatë gjithë këtij viti ka asistuar me grupet e punës dhe ka ndjekur këtë proces hap pas hapi, për të adresuar problematikat e hasura dhe zgjidhjen e tyre.

Ka përfunduar pajisja me kitet e inspektimit për përdorimin e sistemit, sipas parimit një grup pune duhet të ketë një paketë portabël. Gjithashtu, me qëllim funksionimin e këtij procesi, Inspektorati Qendror siguroi shërbimin me 580 njësi USB internet, për të gjitha inspektoratet shtetërore, edhe pse nuk është detyrim ligjor i tij pajisja me këtë shërbim.

Gjatë vitit 2017, inspektoratet e integruara në sistem janë: Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut; Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Drejtoria e Shërbimit Veterinar; Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Për kryerjen e inspektimeve on-line, IQ ka hasur rezistencë nga ISH për zbatimin e detyrimit ligjor në përdorimin teknologjik të sistemit “e-Inspektimit”, dhe për këtë ka urdhëruar kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet Urdhrit nr. 95, datë 16.02.2017 dhe Urdhrit nr. 284, datë 03.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm.

Megjithë angazhimin dhe përpjekjet e IQ, procesi i inspektimeve on-line akoma nuk gjen zbatim nga të gjithë inspektoratet shtetërore duke argumentuar se ka: mungesa të kapaciteteve të burimeve njerëzore në fushën e IT, si suport mbështetës për funksionimin e tij; mungesë njohurish të mjaftueshme në përdorimin e kompjuterit; mungesa e shërbimit të internetit (në disa vende sinjali i shërbimit të internetit është i ulët); bojës së printerit; mungesa e ndonjë subjekti të marrë nga regjistri i QKB-së, në momentin e planifikimit të subjekteve për inspektim.

IQ, thekson se hasja e rezistencës së herë pas hershme për mos vënien në funksion të përdorimit të sistemit “e-Inspektimi”, vjen edhe si mungesë e vullnetit të mirë të disa prej kryeinspektorëve shtetërore.

Referuar të dhënave në sistemin “e-Inspektimi”, për vitin 2017, janë kryer inspektime on-line gjithsej 13.444, krahasuar me 5.060 inspektime on-line për vitin 2016, pra vihet re një rritje prej 2.6 here më shumë, por përsëri kjo rritje nuk është në pritshëmëritë e IQ.¹

Sistemi “e-Inspektimi”, si pjesë e platformës qeveritare të ndërveprimit ka finalizuar ndërveprimin me sistemin e DPT -së (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), DPD (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), DPGJC (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), për shkëmbimin e të dhënave midis Institucionet Shtetërore.

IQ, në bashkëpunim me kompaninë ikubINFO, ka trajnuar gjithsej 622 përdorues të sistemit ku 609 prej tyre janë inspektorë dhe 13-specialistë IT².

Inspektorati Qendror, ka dhënë edhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese lidhur me pajtueshmërinë e zbatimit të ligjeve sektoriale në raport me ligjin e inspektimit, përshtatjen e dokumentacionit standard dhe implementimin e tij në sistemin “e-Inspektimi”, përditësimin e listë-verifikimeve për të gjitha inspektoratet.

Ndër pritshmëritë për vitin 2018 përmendim: kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, për të gjitha Inspektoratet Shtetërore, bashkërendimin e inspektimeve për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që ato kryejnë për të rritur transparencën e veprimtarisë inspektuese drejt qasjeve antikorrupive.

✓ *Vlerësimi dhe testimi i inspektorëve shtetërorë*

Inspektoratin Qendror në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike ka bërë vlerësimin e aftësive profesionale për 905 inspektorë dhe në përfundim të kësaj procedure rezultoi se janë vlerësuar:

¹ Të dhënat e inspektimeve on-line sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij raporti.

² Të dhënat e trajnimit sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij raporti.

- 106 - nëpunës u vlerësuan “Jokënaqshëm”. Këta nëpunës janë të detyruar t’i nënshtrihen një procedure trajnimi pranë ASPA-s dhe një testimi në përfundim të trajnimit, si dhe një periudhë vlerësimi performance 3-mujore;
- 387 - nëpunës u vlerësuan “Kënaqshëm”. Këta nëpunës janë të detyruar t’i nënshtrihen një trajnimi brenda një viti pranë ASPA-s, për plotësimin e njohurive ku ata kanë paraqitur dobësi gjatë procedurës së vlerësimit;
- 393 - nëpunës u vlerësuan “Mirë”;
- 19 - nëpunës u vlerësuan “Shumë mirë”.

✓ *Zbatimi i parimeve të ligjit për inspektimin*

Inspektorati Qendror, në mbështetje të parimeve të ligjit për inspektimin ka hartuar disa draft-VKM, që rregullojnë funksionet e inspektimit në fushën e zbatimit të këtij ligji sipas:

1. **pikës 3, të nenit 21**, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar draft - VKM “Për procedurën e vlerësimit, testimit fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë”, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me Kod Pune, duke përcaktuar rregulla për vlerësimin dhe kualifikimin e inspektorëve me qëllim rritjen e performancës së tyre.
2. **pika 2, neni 26**, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar draft - VKM “Për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar për inspektimin vjetor, si dhe mënyrën e përlogaritjes së saj”, ku do të përcaktohen të gjithë faktorët që mundësojnë funksionimin e subjektit që do të inspektohet dhe çdo element që bën të mundur ushtrimin e aktivitetin për të cilin është licencuar subjekti.
3. **pika 7, neni 38**, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar draft - VKM “Për procedurat për marrjen dhe trajtimin e mostrave si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve në këtë procedurë”, ky draft përcakton rregulla për mënyrën e kryerjes e procedurave për marrjen dhe trajtimin e mostrave, sipas tipit të inspektimit, të produkteve, mallrave, substancave apo prodhimeve, të cilat do t’i nënshtrihen ekzaminimeve apo analizave.
4. **pikës 7, neni 48**, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, IQ ka hartuar draft VKM për “Rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit”. Ky projektvendim përcakton rregulla bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në përputhje me parimin e proporcionalitetit, gjatë procesit të inspektimit, për mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që inspektohen, në mënyrë që dënimi administrativ të jetë përgjithësisht i njëjtë për të njëjtën shkelje, për të shmangur rreziqet që mund t’i shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë të parashikuara me ligj.

Miratimi i këtyre projektvendimeve do të vendosë një uniformitet, transparencë, për arritur një trajtim të njëjtë dhe të barabartë për subjektet e inspektimit, si dhe për të përmirësuar performancën e inspektorëve.

✓ *Udhëheqje metodologjike dhe mbështetje e procesit të veprimtarisë inspektuese.*

IQ, ka synuar të ndërtojë një sistem modern dhe funksional të inspektimeve, i cili të jetë sa më efikas dhe me impakt pozitiv ndaj biznesit dhe publikut.

Nevoja për ndryshim dhe rikonceptimi i “inspektimit”, bën diferencën midis gjendjes të mëparshme, ku pothuajse të gjitha ISH ishin të prirura për të kryer inspektime me blloqe dhe asaj aktuale ku pritshmëritë tona janë kryerja e inspektimeve on-line, pranë subjekteve nga të gjithë trupat inspektuese. Diferenca midis këtyre dy gjendjeve është ajo çfarë duhet të zgjidhë Inspektorati Qendror, në mënyrë që të realizohen pritshmëritë në kohë dhe me cilësi.

Për ndryshimin e këtij mentaliteti, IQ ka hasur vështirësi si në përdorimin teknologjik të sistemit “e-Inspektimit”, edhe në atë të hartimit, përshtatjes dhe plotësimit të dokumentacionit.

Për këtë, IQ ka urdhëruar kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet Urdhrit nr. 95, datë 16.02.2017 dhe urdhrin nr. 284, datë 03.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm, duke i mbështetur në vijimësi ISH lidhur me hartimin e programimit mbi bazë risku, përditësimin e listë-verifikimeve, dokumentet standarde, si dhe zgjidhjen e problematikave të raportuara nga përdoruesit e sistemit, në bashkëpunim edhe me kompaninë ikubINFO.

Për unifikimin e dokumenteve që përdoren gjatë procesit të inspektimit edhe për inspektoratet vendore, në zbatim të ligjit për inspektimin, IQ ka nxjerrë Urdhrin nr. 26, datë 07.03.2017, “Për miratimin e dokuemnteve për dokumentimin e veprimtarisë së inspekitmit për inspektoratet vendore në republikën e Shqipërisë”, të Inspektorit të Përgjithshëm. Theksojmë se përfundimi i këtij procesi do të bëjë të mundur dokumente unike inspektimi edhe për inspektoratet vendore.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Qendror, në mbështetje të veprimtarisë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe me qëllim harmonizimin e legjislacionit drejt përafrimit me direktivat e BE, ka dhënë mendim për disa akte ligjore dhe nënligjore, në fushën e inspektimit, sa më poshtë:

- a. Projektligj, “Për produktet kozmetike”;
- b. Projekt rregullorë “Për procedurat e inspektimit mbi zbatimin e njëzuar të legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të RSH”;
- c. Projektligj, “Për parandalimin e rreziqeve nga aksidente madhore industriale, që përfshijnë substanca të rrezikshme”;

- d. Projektvendim, “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale”;
 - e. Projektvendim, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”;
 - f. Projektvendim, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”;
- ✓ ***Regjistri Kombëtar i Inspektorëve (RKI) në detyrë dhe lëshimi i kartave të inspektorëve shtetërorë në detyrë.***

Në zbatim të pikës h, të nenit 16, të kreut III, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Qendror ka përditësuar Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë dhe Vendorë në detyrë, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al dhe e gjithë trupa inspektuese shtetërore është e pajisur me kartën e inspektorit.

RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT

1. Ministria e Punëve të Brendshme

1.1 Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), në zbatim të ligjit nr . 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, siguron mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, zbatimin e dispozitave në menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe prodhimin e tregtimin e produkteve të ndërtimit.

IKMT-ja, gjatë vitit 2017, në bazë të kërkesave për mbështetjen e institucioneve qendrore /njësive vendore në lidhje me prishjen e objekteve /ndërtimeve kryesisht pengesë për realizimin e projekteve me interes publik, si dhe objekteve të kundërligjshëm të evidentuara, ka prishur gjithsej 1583 objekte.

Gjatë vitit 2017, nga IKMT janë mbajtur gjithsej 421 vendime, nga këto 164 vendime për prishje objekti të kundraligjshme; 50 vendime për pezullim punimesh, si dhe 207 vendime me gjobë me vlerë totale 128.744.640 lekë, ku 7 vendime janë arkëtuar me vlerë 710.000 lekë. Rreth 83% ose 172 raste vendime për dënim me gjobë i përkasin subjekteve të sektorit të kontrollit të territorit dhe 17% të vendimeve janë për rezervat ujore, produktet dhe sektori i mbikëqyrjes së IMT-ve.

Në bashkëpunim me IQ, ka përshtatur dokumentet standard dhe hartuar listë-verifikimet, të cilat janë implementuar në sistemin “e-Inspektimi”. Gjithashtu, janë trajnuar 41 inspektorë për përdorimin e sistemit, është pajisur me 41 paketa portabël dhe usb internet për kryerjen e inspektimeve on-line sipas parimit për çdo grup pune 1-kite portabël, por akoma nuk janë përdorues të sistemit dhe inspektimi kryhet me blloqe.

Për IKMT-në, prioritet mbetet gatishmëria ndaj zhvillimeve me interes publik dhe kombëtar që planifikon qeverisja qendrore.

IKMT-ja, ka si objektiva për vitin 2018, inspektimet në fushat e kontrollit të territorit në zona dhe objekte me rëndësi kombëtare dhe të kushtëzuara në zona të tjera për ndërtimet e kundraligjshme, inspektime në zbatimin e dispozitave ligjore nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore, inspektime në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, inspektime në përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë

2.1 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në VKM nr. 36, datë 20.01.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”, dhe është e organizuar në nivel qendror. ISHMT-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin e zbatimit e kërkesave ligjore për fushat: (1) mbrojtja e konsumatorëve; (2) mbrojtja e pronësisë industriale; (3) garantimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to; (4) inspektimi metrologjik; (5) etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji; (6) kontrolli i detergjenteve të vendosura në treg; (7) kontrolli i produkteve mekanike, ashensorë, pajisje të mbrojtjeve personale; (8) inspektimi i veprimtarive turistike.

Përgjatë vitit 2017, ka planifikuar 2650 inspektime dhe ka realizuar 1078 inspektime, prej të cilave 1020 inspektime të programuara dhe 58 inspektime jashtë programit. Janë vendosur 61 dënime administrative me vendim gjobë dhe Komisioni i Ankimimit të gjobave ka shqyrtuar 22 ankimime dhe të gjitha janë lënë në fuqi, ndërsa 10 çështje janë ankimuar në Gjykatën Administrative ku nga këto: 6 çështje janë rrëzuar, 2 janë pranuar dhe 2 çështje në proces.

Për periudhën Korrik-Gusht 2017, risi e ISHMT-së, është inspektimi në Stacionet e Plazhit lidhur me zbatimin të Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin, në zonat bregdetare që administrohen nga Bashkitë: Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Shkodër, Lezhë, Himarë, Vlorë, Sarandë, Divjakë. U inspektuan 697 subjekte, të cilat ushtronin veprimtarinë e stacionit të Plazhit dhe janë vendosur 50 masa administrative. Mbas datës së inspektimit nga ISHMT-ja duke iu referuar periudhës kohore që iu la subjekteve në dispozicion për të sjellë kontratën, si dhe pagesën përkatëse, rezultoi që 217 subjekte u pajisën me kontrata dhe 113 subjekte kryen pagesën pranë bashkisë. Shuma totale e depozituar në buxhetet e Bashkive, si rezultat i këtij inspektimi ishte 19,646,251 lekë.

Plani i inspektimeve për vitin 2017, nuk u realizua për disa problematika si: mungesa e ambienteve të përshtatshme për punë dhe e logjistikës, mungesa e stafit të kufizuar të inspektorëve, pezullimi i inspektimeve me bllok në zbatim të shkresës të Inspektorit të Përgjithshëm nr. prot 412/7 datë 13.07.2017, testimi i sistemit dhe listë verifikimeve solli moskryerjen e inspektimeve nga muaji Gusht - Nëntor 2017 etj. Inspektorët e metrologjisë dolën në inspektim mbas muajit Gusht për mungesë të autolaboratorëve, të cilët kaluan si kapital nga DPM në ISHMT në shtator 2017.

Të gjitha inspektimet e kryera nga ISHMT-ja janë në pjesën më të madhe të paplanifikuara dhe kjo për faktin se në dispozicion të ISHMT-së nuk u vu asnjë database subjektesh, nga ato struktura: në fushën e metrologjisë, të drejtave të autorit, si dhe turizmit etj.

Disa prej objektivave më të rëndësishme të ISHMT-së për vitin 2018 janë: Kryerja e inspektimeve on-line për kontrollin e kritereve ligjore nga subjektet; Ngritja e databazës për

ashensorët në bashkëpunim me NJQV, institucione publike që kanë në fokus të punës së tyre këtë fushë; Hartimi i një metodologjie të vlerësimit të riskut duke marrë në referencë metodologjinë e vlerësimit të riskut për produktet joushqimore të përdorur nga ana e KE, etj.

2.2 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore të legjislacionit të punës, për sigurimin e kushteve të denja të punës, për mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për ligjshmëri në zbatimin e kohëzgjatjes së punës, për pagesën për punë të kryer konform legjislacionit, për sigurimin e çdo punëmarrësi, për higjenën dhe mirëqenien në vendin e punës, për punësimin e ligjshëm të fëmijëve, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës.

ISHPSHSH, deri në fund të vitit 2017 ka qenë përgjegjëse edhe për inspektimin e strukturave të shërbimit social rezidencial, jo rezidencial, publik dhe privat për respektimin e standardeve ligjore të miratuara, por me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe në zbatim të VKM nr. 508 datë 13.09.2017 “Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, VKM nr. 719, datë 01.12.2017, “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”, Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore transferohet nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

ISHPSHSH, është e organizuar në 12 degë rajonale sipas qarqeve dhe ka 98 inspektorë dhe mesatarisht 81 inspektime në vit për inspektor. Gjatë viti 2017 janë realizuar 7958 inspektime dhe dukë marrë parasysh faktin se numri i subjekteve aktive në fillim të vitit 2017 ka qenë 160679, arrijmë të mbulojmë me inspektime 5% të aktiviteteve ekonomike të deklaruara.

Nga 7958 inspektime të realizuara, 7569 inspektime apo 95.1 % e tyre kanë qenë të programuara (rinspektime, turne të dyta, turne të treta, festa zyrtare apo sezoni turistik), 264 inspektime (3.3%) kanë qenë për shkak ankese, 115 inspektime (1.4%) për shkak aksidenti dhe 10 inspektime (0.1%) kanë qenë inspektime rastësore.

Duhet theksuar se nga 7569 inspektime të realizuara, 6519 inspektime ose 82 % janë realizuar on-line, përmes sistemit “e-Inspektimi”.

ISHPSHSH, ka evidentuar 607 punëmarrës që punonin në mënyrë informale, pa sigurim shoqëror e shëndetësor, ku si rezultat i përdorimit të “masës urgjente”, solli formalizimin e 576-punonjësve të siguar konform legjislacionit të punës.

Në bazë të inspektimeve të inspektorëve të punës të ISHPSHSH-së për vitin 2017, rezulton se janë të punësuar në total 309 fëmijë nën moshën 18 vjeç, prej të cilëve 277 fëmijë punonin me autorizim të inspektorit të punës dhe 32 pa autorizim.

Gjatë vitit 2017, ISHPSHSH ka regjistruar gjithsej 385 ankesa dhe kërkesa, të cilat në varësi të objektit të ankimimit/kërkesës janë trajtuar me inspektim apo verifikim rast pas rasti, ku janë inspektuar 264 subjekte dhe të gjithë ankuesit janë njoftuar zyrtarisht mbi rezultatet e arritura.

Nga muaji Janar - Dhjetor 2017, janë regjistruar 120 raste të aksidenteve në punë, ku kanë mbetur të aksidentuar 137 punëmarrës (9 femra 128 meshkuj), prej të cilëve 18 (meshkuj) kanë humbur jetën. Ndaj 63 subjekteve janë vendosur dënime administrative kryesore, ku 26 prej tyre janë gjobitur për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, apo mosnjoftim të aksidentit në punë pranë ISHPSHH-së, dhe 37 subjekte janë paralajmëruar për gjobë në rast të përsëritjes së shkeljes apo mosplotësim të detyrave të lëna në afatet respektive.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2017 janë deklaruar 10 punëmarrës me sëmundje profesionale, kjo si pasojë e kontrollit të vazhdueshëm në drejtim të marrjes së masave kolektive dhe individuale të mbrojtjes, si dhe rritjes së numrit të subjekteve të cilat mbulohen me shërbim mjekësor.

Mbi punën e bërë gjatë vitit 2017, për evidentimin e standardeve të sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, në total janë inspektuar 74 qendra shërbimi publike dhe jopublike me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Qendrat e inspektuara prekin të gjithë tipologjitë e shërbimeve, (rezidenciale, ditore, multidisiplinare). Në kuadër të punës për rishikimin e akteve nënligjore në përputhje me përcaktimet e reja të bëra nga ligji nr. 121/2016, drejtorja u përfshi në grupin e punës për hartimin dhe rregullimin ligjor për mbi draft VKM, të cilat prekin çështje të strukturimit, të rolit dhe përgjegjësisë së pushtetit vendor, të rolit e përgjegjësisë së Shërbimi Sociali Shoqëror, të tipologjive të shërbimeve të reja komunitare, shërbimeve në familje, kujdestarisë etj.

Gjatë vitit 2017 janë vendosur 80 gjoba nga inspektorët e Degëve Rajonale të ISHPSHSH-së:

36 gjoba me vlerë	6.990.000 lekë	në inspektimet e Programuara
24 gjoba me vlerë	8.620.000 lekë	në inspektimet Tematike
26 gjoba me vlerë	4.966.000 lekë	në inspektimet për Aksident
36 gjobë me vlerë	14.620.000 lekë	në inspektimet për shkak Ankese

Vlera më e madhe e gjobave të vendosura është ajo e gjobave të vendosura në inspektimet për shkak Aksidenti në Punë.

Komisioni i Ankimimit të Gjobave, ka shqyrtuar 29 ankimime, nga të cilat 26 janë lënë në fuqi dhe 3 janë shfuqizuar.

Janë ndjekur dhe fituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë 10 procese gjyqësore, të cilat vazhdojnë të ndiqen në Gjykatën Administrative të Apelit.

Janë arkëtuar 28 gjoba me vlerë 2.868.000 lekë dhe 4 të tjera janë në proces arkëtimi, si dhe janë në proces për tu ekzekutuar 17 masa administrative.

3 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

3.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), ushtron inspektime në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre, e garantimit të sigurisë së njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion, nga pajisjet dhe instalimet elektrike, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut.

ISHTI, realizon funksionet inspektuese në zbatim të VKM nr. 410, datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, nëpërmjet tre drejtorive: Drejtoria e Inspektimit të naftës dhe gazit (D.I.N.G); Drejtoria e Inspektimit të pajisjeve nën presion (D.I.P.N.P); Drejtoria e inspektimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike (D.I.P.I.E).

Aktiviteti inspektues i ISHTI-it kryhet sipas organizimit mbi bazën e strukturës së miratuar konform Urdhrit të Kryeministrit nr. 129, datë 6.11.2012 dhe përbëhet nga 32 Inspektorë të organizuar në 6 sektorë për D.I.N.G; 15 inspektorë të organizuar në 3 sektorë për D.I.P.N.P; dhe 15- inspektorë të organizuar në 3 sektor për D.I.P.I.E .

3.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit(DING), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar; kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit; kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj; kontrollin e cilësisë së nënprodukteve të naftës te konsumatorët e mëdhenj.

D.I.N.G ka planifikuar 6600 inspektime për vitin 2017 dhe ka realizuar gjithsej 8400 inspektime, prej të cilave 540 inspektime janë realizuar me autorizim dhe 7860 pa autorizim.

Objektet e inspektimit të tyre janë lidhur me:

- ✓ Kontrollin e zbatimit të kushteve të parashikuara në Licencat apo Autorizimet që u janë dhënë personave juridikë në Instalimet, Impianteve dhe Pajisjeve përkatëse nga personat juridikë që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat ligjore;
- ✓ Kontrollin e respektimit të standardeve për cilësinë e Naftës dhe Nënproduktet e saj;

Numri i inspektimeve të kryera jashtë programit, në rastet e inspektimeve të posaçme dhe inspektimet në raste aksidentesh është 4, ku janë marrë dhe 4 masa urgjente, dhe 37 janë inspektime jashtë programit por të realizuara me autorizim.

Për subjektet e tregtimit sha, janë marrë 6 masa administrative (gjobë) dhe 70 masa administrative (gjobë) për subjektet e tregtimit shpk.

3.1.2 Drejtoria e Inspektimit të pajisjeve nën presion(DIPNP), ushtron veprimtarinë inspektuese, në zbatim të ligjit nr. 32/2016, datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve Nën Presion, dhe përfshinë :

- ✓ Instalimet nën presion si dhe pajisjet që përdorin operatorët ekonomik që janë licencuar për importimin, magazinimin dhe tregtimin me shumicë të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN);
- ✓ Instalimet në operatorët ekonomik që merren me mbushje, depozitim dhe tregtim bombolash me pakicë;
- ✓ Instalimet nën presion në Autogaze që shërbejnë për furnizimin e automjeteve;
- ✓ Instalimet nën presion që përdoren për qëllime rezidenciale, social-kulturore, industriale, etj.

Gjatë vitit 2017 ka planifikuar 5 353 inspektime dhe ka realizuar 6250, ku : janë planifikuar 1 539 inspektime në subjekte dhe janë realizuar gjithsej 1 983 inspektime, ndërsa për paisjet nën presion janë planifikuar 3 370 inspektime dhe janë realizuar 4 267 inspektime .

Janë lëshuar 415 Urdhëra Ndalimi për paisjet/instalime nën presion për mos kryerje të inspektimit teknik periodik, si dhe për arsye se operatorë ekonomik të ndryshëm kanë mbyllur përkohësisht aktivitetin apo kanë shkëputur nga skema teknologjike paisje të ndryshme duke i kaluar në regjim konservimi.

Nga aktiviteti inspektues në paisje/instalime nën presion nga të 3 Sektorët janë regjistruar për herë të parë 700 paisje nën presion.

Gjatë vitit 2017, kanë ndodhur 4 raste aksidentesh dhe avari gjatë përdorimit të pajisjeve nën presion.

Për vitin 2017, nga Komisioni i Ankimimit të masave administrative pranë ISHTI-it, mbas shqyrtimit të dokumentacionit të mbajtur nga inspektorët, janë vendosur 122 masa administrative me dënim gjobë me një vlerë prej 23 500 000 lekë.

3.1.3 Drejtoria e inspektimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike (DIPIE), inspekton sigurinë elektrike të pajisjeve dhe instalimeve elektrike në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike”, dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Për vitin 2017, D.I.P.I.E ka planifikuar 991 inspektime dhe ka realizuar 897 inspektime të programuara me autorizime dhe 16 inspektime jashtë programit (inspektime të posacme dhe inspektime në raste aksidentesh) , gjithsej janë kryer 913 inspektime.

Gjatë vitit 2017, D.I.P.I.E ka realizuar 107 inspektime tematike në kopshte, çerdhe dhe shkolla në gjithë teritorrin e vendit, në këto drejtime: a) Kontroll i gjendjes teknike të rrjetit elektrik, b) Kontrolli i dokumentacionit teknik të marrjes në dorëzim dhe në procesin e shfrytëzimit të rrjetit elektrik të këtyre objekteve, c) Kontrolli i paisjes me dëshmi aftësie të punonjësve elektrik që shërbejnë në këto objekte.

Aksidentet dhe avaritë e ndodhura në vitin 2017 gjatë përdorimit të pajisjeve/instalimeve elektrike kanë qene gjithsej 12 aksidente, nga këto 9 aksidente me vdekje dhe 3 aksidente me plagosje.

Për shkeljet e konstatuara ka marrë gjithsej 24 masa administrative me vendim gjobë dhe me vlerë 2.770.000 lekë, nga këto janë derdhur 6 gjoba me vlerë 290.000 lekë.

Objektivat e ISHTI-it për vitin 2018 janë: kryerja e inspektime on-line në masën 100%, e cila do të arrihet nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të inspektorëve; kryerja e inspektimeve për kontrollet cilësore në gjithë subjektet e tregtimit me shumicë e pakicë dhe konsumatorët, në mënyrë që gjithë produktet që u ofrohen konsumatorëve të jenë konform standardeve të miratuara; ndjekja me prioritet ekzekutimi i të gjitha sanksioneve të ushtruara në çdo subjekt; rritja e bashkëpunimit me organet e pushtetit Vendor për realizimin e inspektimeve të përbashkëta, si dhe krijimi i bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

3.2 Autoritetit Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera (AKSEM), në zbatim të Ligjit nr. 135/2016, datë 22.12.2016, “Për sigurinë dhe shëndetin në pune emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore në veprat hidro-energjetike”, inspekton sigurinë në punë, të emergjencave dhe shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimeve nëntokësore të veprave hidroenergjetike dhe është e organizuar në nivel qendror.

Referuar programit vjetor 2017, inspektimet e realizuara në subjekte janë bërë duke pasur në konsiderate risqet apo problematikat specifike, tipet e lejeve minerare dhe llojin e veprimtarisë, në përputhje me kriteret ligjore dhe normat teknike të kontrollit të parashikuara në aktet nënligjore dhe janë inspektuar: 3 herë gjatë vitit minierat me regjim ose shfaqje gazi; 2 herë në vit minierat nëntokësore pa regjim gazi; 2 herë në vit punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike; 1 herë në vit minierat sipërfaqësore.

Gjatë vitit 2017, janë programuar 926 inspektime dhe janë realizuar 864 inspektime (përfshirë edhe subjektet që nuk kanë qenë duke punuar në momentin e inspektimit), ndërsa 22 inspektime janë jashtë programi.

Janë marrë 17 vendime të ndërmjetme (13 ndalime punë të pjesshme; 4 ndalime pune të plota), 19 masa administrative paralajmërim, 6 masa administrative gjobë, me një vlerë totale prej 1 000 000 Lekë, ku janë arkëtuar vullnetarisht 3 gjoba me vlerë 400 000 leke, 1 gjobë (100 000 lekë) është në proces ekzekutimi nga zyra përbarimore dhe 2 masa administrative gjobë (500 000 leke) janë në proces njoftimi subjektit për t'u paguar vullnetarisht.

Komisioni Ankimimit, ka shqyrtuar 1-ankimim dhe me vendim ka shfuqizuar masën administrative gjobë prej 300 000 leke, si dhe ka lenë në fuqi vendimin e ndërmjetëm.

AKSEM akoma nuk e realizon procedurën e inspektimit on-line, nëpërmjet portalit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”.

3.3 Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH), funksionon në bazë të nenit 78 të Ligjit Nr. 9317 datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar dhe mbikëqyr sektorin e hekurudhave nëpërmjet kontrollit të rregullave të sigurisë për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore në përputhje me standardet e sigurisë, gjendjen dhe kushtet teknike të trenave, si dhe të pajisjeve hekurudhore etj.

Linjat hekurudhore e rrjetit shqiptar ka një gjatësi të përgjithshme prej 420.63 km, nga të cilat 317.78 km janë gjatësi funksionale dhe jashtë funksionit 106.85 km.

Janë kryer gjithsej 469 inspektime, me një ritëm kontrolli pothuajse të njëjtë gjatë gjithë vitit, me një mesatare afërsisht 38 kontrolle në muaj për inspektor, nga 60 kontrolle që janë realizuar mesatarisht gjatë vitit 2016, kjo si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore dhe përdorimi i sistemit elektronik të inspektimeve, si një qasje e re duke patur vështirësitë e saj.

Janë marrë masë administrative me paralajmërim 21 raste, 1 heqje dëshmi aftësie, si dhe 4 vendim me gjobë me vlerë 14.000 lekë dhe janë arkëtuar 10.000 lekë.

Gjatë vitit 2017, kanë ndodhur 9 aksidente dhe 2 raste janë aksidente me vdekje, krahasuar me vitin 2016 kemi një rënie prej 15 aksidente më pak.

Referuar treguesve të të ardhurave prej 3.406.000 të vitit 2017, të krahasuara me ato të një vitit më përpara 5.190.000 lekë vihet re një rënie, rreth 34.4% më pak të ardhura dhe me pakësim të ndjeshëm të numrit udhëtarëve, kjo vjen nga gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore, shpejtësisë së ulët të lëvizjes së trenave dhe kohëve të gjata të udhëtimeve.

Për përmirësimin dhe zhvillimin e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe për ta bërë sa konkurrent në tregun e transportit është e nevojshme të investohet në infrastrukturën hekurudhore, duke futur në shërbim mjete të reja dhe me kosto të ulët operimi, duke shkurtuar kohët e udhëtimeve të trenave.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit

4.1 Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), në zbatim të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është struktura përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar.

ISHA, ka kontrolluar pajtueshmërinë e veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ka monitoruar, vlerësuar dhe ka nxjerrë përfundime duke dhënë këshillime për zhvillimin e arsimit parauniversitar.

Për vitin 2017, ISHA ka planifikuar 143 inspektime, dhe nga këto 47 janë inspektime të programuara dhe 88 inspektime janë jashtë programit.

Nga 47 inspektimet programuara, 9 prej tyre janë inspektime të plota me qëllim vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucioni arsimor dhe 38 janë inspektime tematike për vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar: në vlerësimin e arritjeve të nxënësve për kurrikulën me kompetenca; në hartimin e planeve vjetore lëndore; në hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të shkollës, në hartimin dhe zbatimin e rregullores së brendshme të shkollës, vlerësimin e njësive arsimore vendore dhe institucioneve arsimore parauniversitare për cilësinë e ofruar në plotësimin e kartës së performancës së shkollës, vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në zhvillimin e praktikave profesionale.

Nga 88 inspektimet e kryera jashtë programit, 58 prej tyre janë orientuar për zbatimin e standardeve të miratuara nga MASR në shkollat qendër komunitare, për zbatimin e VKM-së nr. 473, datë 01.06.2017, të Këshillit të Ministrave, nga institucionet në varësi të MASR, si dhe vlerësimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore private, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe 30 inspektime për shqyrtimin e rasteve të ankimeve.

Përveç inspektimeve, ka monitoruar edhe 265 raste lidhur me: Portalin “Mësues për Shqipërinë”, Olimpiadat; Maturës Shtetërore 2017; Provimet e Lirimit 2017; Për zgjidhjen dhe shitjen e teksteve shkollore; Testimin e klasave kolektive II-IX.

ISHA, i ka propozuar Ministrin të MASR, 3 masa administrative, për mbylljen e veprimtarisë mësimore për 3 shkolla jopublike (9 vjeçare dhe të mesme) dhe 1 prej tyre kallëzim penal.

Gjatë vitit 2017, ISHA me koordinimin dhe mbikëqyrjen e Inspektoratit Qendror nga muaji Qershor i ka zhvilluar të gjitha inspektimet on-line, duke rritur transparencën, efektivitetin dhe besueshmërinë e veprimtarisë inspektuese si dhe duke mundësuar inspektime dhe vendimarrje në kohë reale në institucionet arsimore parauniversitare.

Objektivat e ISHA-së për vitin 2018 është realizimi i të gjitha inspektimeve on-line, bazuar në metodologjisë e vlerësimit të riskut, identifikimi dhe promovimi i praktikave më të mira, në arsimin parauniversitar, informimi i grupeve të interesit me anë të raporteve të inspektimit, letrave informuese.

5 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

5.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), nuk ka paraqitur raportin vjetor për vitin 2017, duke mos përmbushur detyrimin ligjor në zbatim të nenit të 16 të ligjit për inspektimin.

5.2 Drejtoria e Shërbimeve Veterinare (DSHV), nuk ka paraqitur raportin vjetor për vitin 2017, duke mos përmbushur detyrimin ligjor në zbatim të nenit të 16 të ligjit për inspektimin.

5.3 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës (DSHPA), në zbatim të Ligjit 64/2012 për Peshkimin (i ndryshuar), VKM-së nr 44 datë 29.01.2014 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”, i ndryshuar, është struktura përgjegjëse lidhur me garantimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në mbrojtjen e peshkimit dhe akuakulturës.

Spektori i Monitorimit Inspektimit ka kryer kontrole dhe inspektime të vazhdueshme në subjektet që zhvillojnë aktivitetet peshkimi në këto drejtime kryesore:

- ✓ inspektime për peshkimin gjatë bregdetit dhe në ujërat e brendshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ inspektime në subjektet e akuakulturës në det dhe në ujërat e brendshme;
- ✓ inspektime nëpër tregje, në merkatot e peshkut për disiplinimin e tregtimit të produkteve të peshkore të llojeve të ndaluara, po kështu edhe në drejtim të pajisjes së subjekteve me çertifikatën e origjinës, me qëllim identifikimin e origjinës së produkteve të peshkut.
- ✓ inspektime dhe kontrole në Portet e peshkimit, laguna dhe ujëmbledhesa për subjektet që kryejnë aktivitetet peshkimi ku kemi propozuar shfuqizimin e kontratave pasi nuk janë plotësuar kushtet për disa prej tyre.
- ✓ Është zbatuar me rigorozitet Urdhri i Ministrit për ndalimin e gjuetisë në liqenin e Ohërit, si dhe është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme liqeni i Shkodrës dhe i Prespës.

Duke filluar nga data 12.07.2017, Spektori të Monitorim Inspektimit të Peshkimit ka nisur inspektimin on-line nëpërmjet sistemit e-inspektimi.

Gjatë vitit 2017, Spektori i Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e Peshkimit ka kryer gjithsej 1409 Inspektime, nga të cilat 874 inspektime të pa programuara dhe 535 inspektime të programuara.

Duke filluar nga data 12.07.2017, Sektori i Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit ka nisur inspektimin on-line në të gjithë Republikën e Shqipërisë nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi” dhe janë kryer 316 inspektime.

Janë marrë 43 masa administrative (dënim me gjobë), nga të cilat 38 prej tyre janë ekzekutuar dhe vetëm për 5 masa i janë drejtuar Gjykatave.

Për arritjen e objektivave ka hasur problematika, si: mungesa e burime njerëzore për çdo port, për monitorimin 24/7 orë për kontrollin e peshkarexhave në det, së paku në katër portet e peshkimit të Shqipërisë, për t’iu përgjigjur në kohë reale situatave, të cilat raportohen nga QNOD, si dhe ndjekja e zinxhirit të peshkimit që nga zënia, mbajtja në bord, transportimi në barkë dhe hedhja në treg ose për konsum.

Anijet e peshkimit në porte, zakonisht dalin në gjueti në orët e para të mëngjesit (rreth orës 1.00-3.00) dhe kthehen në orën 20.00-22.00, kështu që është e pamundur verifikimi i tyre në momentin e nisjes për kontrollin e pajisjeve dhe veglave të peshkimi si dhe verifikimin e mbërritjes në port për verifikimin e produktit peshkor.

Mos funksionimi i sistemit të monitorimit të anijeve të peshkimit mungesa e plotë e sinjalit satelitor Blu-Box, i cili bën të mundur evidentimin e subjekteve të cilat kryejnë peshkim të paligjshëm apo në zona me regjim të kufizuar, duke vështirësuar evidentimin në kohë reale të subjekteve.

Gjithashtu, ka mungesë të mjeteve motorike lundruese dhe automjete për kryerjen e inspektimeve në terren dhe në det pasi sipërfaqet e terrenit për inspektim janë të mëdha.

Një risi për 2017 është përdormi i sistemit “e-Inspektimi”, ku vlen këtu për tu theksuar mundësia i krijimit të çështjeve me ID, e cila tani na mundëson evidentimin e subjekteve te paligjshëm të cilët nuk disponojnë NIPT, gjë e cila më parë ishte e pamundur.

6 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

6.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), në zbatim të VKM-së nr. 241, datë 27.03.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror shëndetësor”, është struktura përgjegjëse për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik nëpërmjet veprimtarisë inspektuese të produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë.

Aktiviteti Inspektues i ISHSH për vitin 2017, është rritur dhe ka kryer gjithsej 45 535 inspektime, ku pesha specifike më e madhe prej 35% të inspektimeve është për mbrojtjen nga duhani.

Veprimtaria inspektuese gjatë vitit 2017 për respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik, përfshin:

- ✓ 14 918 Inspektime sanitare në subjektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregëtimit të produkteve të të gjitha llojeve dhe në të gjitha kategoritë e punimeve minerare, si dhe në repartet dhe strukturat në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në ato të Ministrisë së Rendit, në pikat kufitare, portet, aeroportet, doganat, si dhe në mjetet e transportit tokësor, hekurudhor, detar, vendas e të huaj;
- ✓ 2 764 Inspektime higjieno-sanitare të institucioneve arsimore, parashkollore, shkollore, universitare, mensave dhe konvikteve në funksion të këtyre institucioneve;
- ✓ 24 Inspektime higjieno-sanitare, menaxhimit të mbetjeve spitalore dhe për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në institucionet e ekzekutimit të dënimit të veprave penale dhe të paraburgimit;
- ✓ 40 Inspektime të spitaleve publike dhe jopublike (inspektime spitalore);
- ✓ 7 952 Inspektime dhe monitorime shëndetësore dhe higjieno-sanitar para fillimit dhe gjatë sezonit turistik në zonat turistike;
- ✓ 311 Inspektime ambulatore;
- ✓ 665 Inspektime në klinikat mjekësore estetike jopublike dhe qendrave kozmetike dhe estetike;
- ✓ 709 Inspektime në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm (mbrojtja e shëndetit publik);
- ✓ 883 Inspektime për zbatimin e ligjit Nr. 9928, i ndryshuar, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”;
- ✓ 110 Inspektime për zbatimin e ligjit Nr. 8528, i ndryshuar “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”;
- ✓ 242 Inspektime për zbatimin e ligjit nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar;
- ✓ 9 Inspektimet për zbatimin e ligjit nr. 8025, date 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”;
- ✓ 809 Inspektime të subjekteve për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë;
- ✓ 101 Inspektime të institucioneve shëndetësore prodhuese të mbetjeve spitalore publike dhe jo publike;
- ✓ 15 998 Inspektime për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”;

ISHSH, ka marrë gjithsej 461 masave administrative (gjobë) në të gjitha qarqet, nga të cilat 186 janë në proces gjyqësor, 161 masa administrative janë lëshuar tituj ekzekutive dhe 114 janë arkëtuar.

Objektivat e ISHSH për vitin 2018 janë: përdorimi i portalit “e-Inspektimi” nga të gjithë inspektorët pa ndërprerje; ngritja e njësive kufitare të inspektimit, si dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të resurseve njerëzore; përmirësimi i kuadrit ligjor për fushën e shëndetit publik.

6.2 Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), vepron në zbatim të ligjit nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”.

Veprimtaria inspektuese dhe kontrolluese e rrjetit farmaceutik konsiston në: mbikëqyrjen dhe inspektimin e subjekteve farmaceutike (depo, farmaci, agjenci farmaceutike) në drejtim të respektimit të kërkesave ligjore që kanë të bëjnë me tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave, të kushteve të ruajtjes së shpërndarjes së mirë të barnave, monitorimin e publicitetit për barnat, dhe inspektimin e pajisjeve mjekësore.

Gjatë vitit 2017, janë inspektuar dhe kontrolluar 424 subjekte inspektimi nga të cilat:

- ✓ 352 -subjekte farmaceutike dhe agjenci farmaceutike;
- ✓ 48-raste depo importuese dhe/ose shpërndarës farmaceutikë;

Për vitin 2017 janë marrë 25 masat administrative: dënim me gjobë dhe/ose sekuestrim i barnave dhe/ose të konfiskuara, të vendosura për subjektet farmaceutike si: depo importuese; farmaci; agjenci farmaceutike.

Në veprimtarinë inspektuese të Agjencisë mbetet problematikë monitorimi në kohë reale i subjekteve farmaceutike, pa qenë pjesë aktive e procesit të licencimit. Licencimi i subjekteve farmaceutike me vetëdeklarim, efektivisht ka sjellë problematika në shërbimin farmaceutik në drejtim të mungesës së ofrimit të shërbimit nga stafi i kualifikuar dhe profesional i detyrueshëm sipas ligjit për barnat apo mospërmbushjes së praktikave të ruajtjes dhe tregtimit të mirë të barnave.

Përballë fenomeneve si licencimi i subjekteve farmaceutike (farmaci dhe agjenci) duke patur të njëjtin drejtues teknik, në kundërshtim të plotë me ligjin e barnave, ushtrimi i aktivitetit farmaceutik të palicensuar apo licencimi i farmacive "inekzistente" (që nuk janë aktive në treg), e bën të domosdoshme pjesëmarrjen e Agjencisë në procesin e verifikimit paraprak të subjekteve farmaceutike (farmaci/agjenci farmaceutike) që aplikojnë për licencim pranë QKL.

AKBPM duhet të ketë të drejtën të bëjë vlerësimin e subjekteve farmaceutike nëse këto plotësojnë kushtet për ruajtjen e mirë të barnave dhe nëse kanë të pranishme pjesën më të madhe të barnave të detyrueshme të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Në Korrik 2017 është implementuar në sistemin "e-Inspektimi", dhe janë realizuar inspektimet on-line në veprimtarinë inspektuese të Agjencisë, në përputhje me Udhëzimet, Urdhrat dhe orientimet e Inspektoratit Qendror, por ende ka vend për përmirësime.

6.3 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR), kryen veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese”, dhe siguron mbrojtjen

nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar, popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe monitorimi i rrezatimeve jojonizuese.

ZMR-ja, për vitin 2017 ka realizuar 43-inspektime, prej të cilave 35-inspektime të programuara dhe 8-inspektime jashtë programit. Gjatë procesit të inspektimit janë vendosur gjithsej 11-dënime administrative (5-paralajmërime; 5-heqje licence; 1-pezullim licence) dhe nuk është ankimuar asnjë nga këto masa administrative.

Gjatë muajit Korrik 2017, ZMR-ja ka filluar kryerjen e inspektime në sistemin on-line në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ka kryer 12 inspektime on-line (11 inspektime të programuara dhe 1 inspektim jashtë programit).

ZMR, nuk ka filluar akoma procesin e inspektimit të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, që përfshin antenat celulare, kjo për arsye të mungesës së kapaciteteve të burimeve njerëzore, gjë e cila e bën të pamundur inspektimin në terren të këtyre burimeve me të njëjtin numër inspektorësh që bëjnë dhe vlerësimin për pajisjen me Akt Miratimi të tyre, të pajisjeve të punës etj.

Objektivat e ZMR-së për vitin 2018, planifikimi i inspektimeve mbi bazën risku, frekuencës kohore dhe performancës së subjekteve dhe kryerja e inspektimeve on-line.

7 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

7.1. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve dhe ushtron funksionet e veta në zbatim të VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror të mjedisit dhe pyjeve”.

Aktiviteti inspektues realizohet nga dy drejtori, Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore, me qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, pyjeve, shëndetit të njerëzve dhe cilësisë së jetës.

7.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit (DIM), ka në përbërjen e saj 112 inspektorë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2017, DIM ka pasur në fokus inspektimin e subjekteve për menaxhimin e mbetjeve urbane; inspektimin e subjekteve për menaxhimin e mbetjeve spitalore; inspektimin e subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore lidhur me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore; identifikimin e subjekteve pa leje mjedisore dhe kontrollin e tyre; si dhe bashkëpunimi me DRM-të dhe AKM për pajisjen e këtyre subjekteve me lejen përkatëse mjedisore të tipi A, B, C, si dhe verifikimi i

ankesave të bëra në portalin e bashkëqeverisjes: “Për Shqipërinë që duam”, në portalin “Anti-korrupsion” dhe “Mjedisi im”.

Në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror dhe me projektin IBECA janë kryer trajnime për inspektimet on-line, por deri tani për shkaqe të ndryshme, inspektorët e DIM nuk janë përdorues të portalit “e-Inspektimi”, edhe pse dokumentet standard të inspektimit janë hartuar dhe implementuar në portal.

Gjatë vitit 2017, në fushën e mjedisit ka realizuar 4 152 inspektime gjithsej nga këto 3 372 janë të programuara; 780 Inspektime jashtë programit; 4 152 Inspektime me Autorizim; 1 773 Inspektime me njoftim; 2 379 Inspektime pa njoftim;

Nga inspektimet e realizuara, DIM ka vendosur 166 masa administrative (gjobë) me një verë prej 86 465 000, 1 dënim me paralajmërim dhe 91 pezullime dhe mbyllje aktiviteti.

DIM, ka hasur në disa vështirësi si: kontrolli i vërtetësisë së të dhënave për normat e shkarkimeve në ajër pasi Strukturat e Ministrisë së Mjedisit (AKM, ISHMP, vete MM) nuk kanë laboratorë të akredituar; disa subjekte nuk dërgojnë rregullisht në rrugë zyrtare raportet e vet monitorimit në AKM dhe ISHMP çdo 6 muaj; disa subjekte që hyjnë tek kategoria e aktiviteteve prodhuese kryesisht me leje mjedisore të tipit C, rezultojnë pa leje mjedisore; disa subjekte nuk kanë kryer vlerësimin strategjik mjedisor një herë në 3 vjet si, kusht i lejes mjedisore.

Për vitin 2018 synohet forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet aftësisë tekniko-profesional nëpërmjet trajnimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me mbështetjen e projekteve të BE që asistojnë në fuqizimin e kapaciteteve institucionale të Inspektorateve të Mjedisit; kryerja e inspektimeve on – line nëpërmjet sistemit “ e-Inspektimi”; përditësimi i regjistrimit të të dhënave për subjektet ushtrojnë aktivitetin në bazë të Ligjit nr. 10448, date 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”.

7.1.2 Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore (DIPP), gjatë vitit 2017, ka ushtruar inspektime në bashkitë e 12 qarqeve të vendit dhe ka evidentuar rajonet me problematike si: Korça, Tirana, Elbasani dhe Dibra, të cilat janë qarqet me numrin më të madh të kundërvajtjeve administrative në pyje.

Janë ngritur grupe pune për evidentimin e problematikave në pyje, në zbatim të urdhrit nr. 16, datë 06.11.2017, “Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë”, ku janë evidentuar: subjektet që shfrytëzojnë pyjet, kullotat dhe bimët; ndërhyrjet dhe aktivitetet në Zonat e Mbrojtura; subjektet e përpunimit dhe manipulimit të lëndës drusore dhe druve të zjarrit, si dhe evidentimi i gjuetisë së paligjshme, kafshëve në aktivitet dhe i prerjeve të paligjshme.

Në 228 raste janë sekuestruar lëndë drusore me volum gjithsej 1005.1 m³ dhe respektivisht 151.41 lëndë punimi dhe 853.8 dru zjarri. Sekuestrimet më të mëdha janë realizuar në rrugë automobilistike.

Numri total i drurëve të prerë në mënyrë të paligjshme ka qenë 9 704 drurë me volum 2 216 m³ . Sasitë më të mëdha të prerjeve të paligjshme janë konstatuar në qarqet: Dibër me 2871 drurë dhe vëllim 654.7 m³, Korçë 2 136 drurë dhe vëllim 132.8 m³ , Shkodër 1 780 drurë dhe vëllim 436.6 m³.

Janë kryer 11 procedime në fondin kullosor me vlerë dëmi 7 245 000 lekë dhe janë vendosur 460 000 lekë gjobë për dëmtime në fondin kullosor.

Janë inspektuar të gjithë guroret në fonde pyjore dhe kullosore në bashkëpunim me AKZM-në dhe ARM-në sipas urdhrin nr. 10, datë 11.01.2018 “Për kontrollin e zbatimit të kërkesave për respektimin e standardeve mjedisore dhe të lejes minerare nga subjektet e shfrytëzimit minerar”.

Janë ushtruar 904 inspektime në zonat e gjuetisë në, Shkodër, Korçë, Berat, etj. Janë proceduar për gjueti të paligjshme 20 persona dhe janë vendosur masa administrative me vlerë gjobe 1 423 000 lekë gjithsej.

Gjatë vitit 2017 janë konstatuar gjithsej 436 raste zjarresh me sipërfaqe të përkrahur 12 473.58 ha, nga kjo në kullota 5 677.75 ha. Sipërfaqe e djegur në pyje ka qenë 1 883.56 ha, në kullota 5301.66 ha. Nga këto në kullota private, sipërfaqja e djegur në hektarë është 893. Materiali drusor i djegur është 4 546.9 m³ndërsa materiali drusor i përdorshëm 14 109.6 m³.

Vlera e dëmit e përllogaritur arrin vlerën e 217 milionë lekëve.

Nga analiza e shkaqeve të rënies së zjarrit rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë të panjohura dhe nuk janë zbuluar autorët. Rreth 85% të rasteve të shfaqjes së zjarreve janë identifikuar autorët në 15% të cilët u janë dorëzuar organeve kompetente. Identifikimi i tyre është bërë në bashkëpunim me Emergjencat Civile, AKZM-të dhe me administratën e bashkive.

Për vitit 2017 janë realizuar 5500 inspektime nga të cilat: 904 për gjuetinë e paligjshme dhe pjesa më e madhe për kundërvajtjet në fondin pyjor e kullosor.

Krahasuar me vitin 2016 ka një rënie të numrit të inspektimeve, nga 8000 inspektime të autorizuara të vitit 2016-të. Këta tregues vijnë, si pasojë e vështirësive hasur në regjistrimin online të fillimit të procesit të inspektimeve dhe të trajnimit të inspektorëve për implementimin e këtij procesi për vitin 2018.

Numri i kundërvajtjeve penale dhe administrative është më i ulët. Janë mbajtur rreth 20% më pak të proces-verbaleve për kundërvajtje në fond pyjor dhe në gjueti si rezultat i uljes së presionit mbi pyje nga efektet pozitive të zbatimit të Moratoriumit të Pyjeve.

Janë proceduar dhe dërguar për ndjekje penale për prerje të paligjshme 19 subjekte me vlerë dëmi 24 224 362 000 lekë nga 32 të proceduar për vitin 2016. Qarku Korçë, ashtu si dhe në treguesit e viteve më parë, mbetet qarku me numrin e kundërvajtjeve më të larta penale, përkatësisht 11 kundërvajtje ku 10 prej tyre janë për Zonat e Mbrojtura dhe Parqet Kombëtare.

Nga inspektimet e bëra në rrugë automobilistike, në subjekte të përpunimit të lëndës drusore Inspektorët kanë sekuestruar lëndë drusore të prerë në mënyrë të kundërligjshme në 228 raste me volum 1005.1 metër kub në krahasim me 246 raste nga viti i shkuar. Treguesit pasqyrojnë diferencë të vogël të rasteve të sekuestruara të lëndëve drusore ndërmjet dy viteve të fundit.

7.2 Inspektorati Shtetëror i Ujërave (ISHU), ka ushtruar funksionet e tij në zbatim të VKM nr. 386, datë 06.05.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Ujërave”, dhe siguron respektimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së ujërave.

Aktiviteti Inspektues përgjatë vitit 2017, në zbatim të kërkesave të Ligjit 111/2012, ”Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, janë realizuar gjithsej 1 330 inspektime dhe janë marrë 120 masa administrative (gjobë) lidhur me:

- ✓ Shfrytëzimin e inerteve lumore inspektimeve nga subjekte që shfrytëzojnë inerte lumore për pajisje e tyre me lejet përkatëse;
- ✓ Rehabilitimin e zonës së shfrytëzuar sipas kushteve të lejes së shfrytëzimit të parashikuara në “Projektin e Rehabilitimit të Sipërfaqeve të Shfrytëzuara”;
- ✓ Pajisjen me dokumentacion dhe formularët e lejes së përdorimit të ujit për tu pajisur me leje , autorizim për përdorimet e burimeve ujore nga subjektet përdorues uji;
- ✓ Shkarkimin e ujërave të përdorur dhe trajtimin parësor të tyre nga subjekte të cilat si pasojë e procesit të punës kanë shkarkime;
- ✓ Kontrollin për parandalimin e shpimeve për nxjerrje uji pa u pajisur me lejet përkatëse si dhe inventarizimi i puseve të shpuara në vite pa studime dhe pa leje;

ISHU, ka marrë 121 masa administrative (gjobë) me vlerë 43 810 000 lekë dhe nga këto janë arkëtuar gjithsej 20 000 lekë. Janë shqyrtuar nga trupa kolegjiale 38 gjoba, nga të cilat 12 prej tyre janë lënë në fuqi, 24 prej tyre janë shfuqizuar dhe 2 janë ndryshuar, ndërsa 83 masa të tjera nuk janë ankimuar.

ISHU, për vitin 2017, nuk ka realizuar inspektime on-line nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”.

ISHU, për vitin 2018 do të jetë pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në zbatim të VKM nr. 659, datë 10.11.2017, “Për disa ndryshime në VKM nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror të mjedisit dhe pyjeve”, i ndryshuar dhe do të ketë si prioritet rritjen e efektivitetit të inspektimeve në fushën e burimeve ujore, inerteve lumore dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura si dhe rishikimin e bazës ligjore në fushën e mbrojtjes së ujërave.

8 ***Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave***, ka për mision kontrollin e zbatimit të legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria e saj inspektuese, është hartuar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit nr. 4 datë 19.06.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave “Rregullore e njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

Drejtoria e Arkivave, në zbatim të VKM-së nr. 360, datë 26.04.2017, “Për organizmin dhe funksionim e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, ka filluar kryerjen e inspektimeve sipas ligjit për inspektimin. Gjatë 6-mujorit të dytë të këtij vitit, në bashkëpunim me IQ ka finalizuar dokumentet standarde dhe listë-verifikimet, të cilat tashmë janë të implementuara edhe në sistemin “e-Inspektimi”.

Janë kryer gjithsej 42 inspektime, nga këto 40 inspektime të programuara dhe 2-inspektime jashtë programit. Veprimtaria inspektuese është kryer në formë shkresore duke përdorur dokumentet standard dhe listë-verifikimet. Janë trajnuar dhe ri-trajnuar për përdorimin e sistemit për kryerjen on-line të inspektimeve, por akoma nuk janë përdorues të tij.

Nga inspektimet e kryera, janë konstatuar disa problematika kryesore të cilat janë: nuk është ngritur komisioni i ekspertizës në disa institucione; nuk është miratuar lista dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre; nuk është kryer përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve me RHK dhe, nuk është bërë dorëzimi i tyre, në Arkivin Shtetëror sipas ligjit, ku janë dhënë edhe rekomandimet për përmirësimin e tyre. Nuk ka patur masa administrative gjobë.

Për vitin 2018, në bazë të programit vjetor të inspektimit, do të kryhen inspektime on-line, si një proces i rregullt administrativ dhe ligjor.

V. KOMENTE

Nga ky raport, del në pah se gjatë vitit 2017, përgjithsisht ka gjetur zbatim procedural ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nga inspektoratet shtetërore, të cilët kanë finalizuar unifikimin e procedurës së inspektimit dhe përditësimin e listë verifikimeve.

Inspektorati Qendror në bashkëpunim me kompaninë ikubINFO ka përfunduar implementimin e të gjithë dokumentacionit në sistemin “e-Inspektimi”, por megjithë këmbënguljen dhe urdhërimin herë pas here akoma nuk janë përdorues të këtij sistemi të gjitha ISH.

Inspektoratet shtetërore ende nuk kryejnë programimin e veprimtarisë së tyre inspektuese, vjetor/mujor, në bazë të metodologjisë së vlerësimit të riskut, si një metodë bashkëhore me qëllim parandalimin e rreziqeve në të gjitha fushat e inspektimit, të cilat kanë impakt të ndjeshëm në ambientin rrethues dhe interesat e publikut.

Nga mbikëqyrja e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, IQ ka vërejtur se ka mbivendosje të ligjeve sektoriale për fushat e inpektimit, duke anashkaluar përgjegjësinë nga njëri inspektorat në tjetrin.

Për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve shtetërorë, IQ ka trajnuar dhe ritrajnuar 609-inspektorë dhe 13-specialistët e IT, për përdorimin e sistemit on-line të inspektimit. Gjithashtu, Departamenti i Administratës Publik në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror ka bërë vlerësimin e aftësive të tyre profesionale për 905 insepktorë shtetërore.

Janë bërë takime pune të përbashkëta me inspektoratet shtetërorë dhe me dhomat e biznesit, të cilët janë informuar për qasjen e re të isnektimeve pranë çdo subjekti privat, të cilët tashmë mund të marrin të dhëna në kohë reale nga faqja e internetit të IQ, si: identifikimin e inspektorëve nga regjistri kombëtar i inspektorëve, listëverifikimet, ku janë të listuara të gjitha detyrimet ligjore që duhte të zbatojë subjekti objekt inspektimi.

Gjithashtu, objekt i mbikëqyrjes së Inspektoratit Qendror kanë qenë edhe trajtimi i ankesave për masat administrative të marra nga inspektoratet shtetërore, ndaj subjekteve.

Inspektorati Qendror, ka pajisur të gjithë inspektorët shtetërorë me paketa portabël sipas parimit një laptop për një grup inspektimi, si dhe ka ofruar edhe 580 USB për shërbimin e internetit.

Ka pajisur me kartë inspektori të gjithë inspektorët shtetërore të trupave inspektuese, si dhe ka përditësuar regjistrin kombëtar të inspektorëve shtetërore dhe vendorë.

VI. PRAKTIKAT E MIRA

Inspektorati Qendror, në zbatim të Urdhrit nr. 95, datë 16.02.2017 dhe urdhrit nr. 284, datë 03.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për kryerjen e inspektimeve on-line”, gjatë mbikëqyrjes së inspektorateve shtetërore për kryerjen e kësaj veprimtarie mund të përmendimin Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si një nga praktikat e mira, ku pothuajse rreth 85% e aktivitetit inspektues kryhet on-line, nëpërmjet sistemi unik të inspektimit “e-Inspektimi”.

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

Në kuadër të përmbushjes së gjithë aktivitetit të Inspektoratit Qendror, buxheti i institucionit është shpenzuar për kryerjen e detyrave funksionale të këtij institucioni. Plani i buxhetit të vitit 2017, i miratuar nga Ministria e Financave, për Inspektoratin Qendror, ka qenë 107 004 000 lekë në total dhe i detajuar sipas zërave më poshtë:

000 / lekë

BUXHETI I VITIT 2016					
Nr	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Plani 2017	Fakti 2016	Diferenca Plan/Fakt	Realizimi i buxheti në %
1	Paga, shpenzime të tjera personeli	28 500	19 165	9 335	67.24 %
2	Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4 500	2 852	1 648	68.38 %
3	Mallra, shërbime dhe shpenzime të tjera operative	13 000	10 052	2 948	77.32 %
4	Investime	61 004	59 960	1 044	98.29 %
	TOTALI	107 004	92 029	14 975	86.00 %

Buxheti vjetor u realizua sipas akteve ligjore ekonomiko-financiare në fuqi për të gjitha zërat e tij.

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë vlera e investimeve, e cila ka një peshë specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve buxhetore, ndërsa fondi i pagave me kontributin e sigurimeve në vlerë absolute është më i vogël.

Zëri i buxhetit 231 “Investime”, i cili ishte me një vlerë totale prej 61 004 000 lekë, u realizua në masën 98.29 %. Pjesën më të madhe e zënë blerje e projektit për një godinë të re të Inspektoratit Qendror, në kuadër të reformimit të inspektorateve shtetërore, në vlerën 27 957 775 lekë . Zëri i dytë me peshë është blerje automjete te Inspektoratit Qendror në vlerën 16 920 000 lekë, që do të lehtësojnë veprimtarinë inspektuese. Zëri i tretë me peshë është shërbim i mirëmbajtjes së portalit në vlerën 9 450 000 lekë.

Gjithashtu, për të gjitha procedurat e prokurimit është zbatuar Ligji i Prokurimit Publik.

I gjithë buxheti i miratuar për vitin 2017 u realizua në masën 86.00 % të fondit të miratuar për t’u shpenzuar për këtë periudhë.

Inspektorati Qendror, për vitin 2018 ka hartuar një buxhet realist, i cili do të lejojë të kryejë në kohë të gjitha aktivitetet e planifikuar, për përmbushjen e misionit të tij.

VIII. REKOMANDIME

Referuar analizës së kryer mbi aktivitetin e Inspektorateve Shtetërore për vitin 2017 dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre gjatë kësaj periudhe, rekomandohet si më poshtë:

- Kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet paketave portabël në sistemin unik “e-Inspektimi”, nga të gjithë inspektoratet shtetërore, me qëllim krijimin e një procesi inspektimi transparent dhe në kohë reale, duke shmangur inspektimin tradicional me blloqe.
- Të hartohet programimi vjetor/mujor i veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, për të bërë të mundur parandalimin e rreziqeve që vijnë nga subjektet me rrezikshëmëri të lartë.
- Të bëhet kategorizimi i subjekteve me risk më të lartë me qëllim identifikimin, parandalimin ose minimizimin e riskut, sipas udhëzimeve të Urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- Inspektoratet Shtetërore të hartojnë treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së punës së tyre, sipas udhëzimeve të Urdhrit nr. 7, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit e raportimit të tyre”.
- Të bëhet përafrimi i legjislacionit me direktivat e BE, për fuqizimin e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore.
- Të përditësohen rregulloret dhe sidomos ato teknike të inspektorateve shtetërore.
- Të rishikohet baza ligjore e mbivendosur e Inspektorateve Shtetërore, duke bërë ndarjen e kompetencave .
- Nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, të organizohen inspektime të përbashkëta me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
- Inspektoratet shtetërore, të publikojnë të dhënat e veprimtarisë së tyre për të rritur transparencën ndaj publikut.
- Inspektorati Qendror të ushtrojë mbikëqyrje efektive mbi kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve për të rritur përgjegjshmërinë në punë dhe performancën e inspektorëve.
- Të përditësohen website e inspektorateve shtetërore, të publikojnë broshurë për subjektet me procedurat e inspektimit dhe informacione të tjera të vlefshme për një partneritet më të mirë me subjektet inspektuese. Informimi i subjekteve dhe publikut duhet të

përmirësohet më tej në mënyrë që subjektet e inspektimit që operojnë në Shqipëri dhe publiku të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre.

- Të bëhet informimi i biznesit nga ana e Inspektoratit Qendror rreth aktivitetit të tij si institucioni përgjegjës për rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

IX. KONKLUZIONE

Ecuria dhe rezultatet e reformës në inspektim do të arrihen nëpërmjet përmbushjes së të gjitha objektivave të mësipërme, duke patur komunikim të vazhdueshëm ndërinstitucional me të gjithë aktorët e kësaj reforme.

Ka përfunduar përshtatja e dokumenteve standarde dhe hartimi i listë-verifikimeve për të gjithë inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese dhe janë implementuar në sistemin unik të inspektimeve “e-Inspektimi”.

Megjithë angazhimin dhe përpjekjet e Inspektoratit Qendror për kryerjen e inspektimeve on-line, akoma nuk gjen zbatim kjo qasje e re inovative nga të gjithë inspektoratet, e cila do të sjellë rritjen e transparencës, uljen e barrës administrative ndaj biznesit dhe reduktim të veprimeve abuzive.

Kapacitetet e burimeve njerëzore kanë nevojë akoma për përmirësim, prandaj është e domosdoshme hartimi dhe zbatimi i procedurave të trajnimit dhe vlerësimit të inspektorëve.

Janë pajisur të gjithë trupa inspektuese me paketa portabël për kryerjen e inspektimeve on-line.

Është përditësuar regjistri kombëtar i inspektorëve shtetërore/vendore, si dhe janë pajisur me kartën e re të inspektorit shtetëror, duke evituar inspektimet e paligjshme të personave jashtë inspektorateve shtetërore.

Inspektorati Qendror duhet të rrisë më shumë rolin e vet mbikëqyrës të veprimtarive të inspektimit, për të siguruar zbatimin e ligjit të inspektimit dhe ligjeve sektoriale nga ana e inspektorateve shtetërore.